

# TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

## Përmbajtja

- I. Seminari i të premtës
- II. Punët kërkimore të sapopërfunduara
- III. Materiale diskutimi në proces
- IV. Artikuj
- V. Të ndryshme

## I. SEMINARI I TË PREMTES

Edhe gjatë periudhës korrik-dhjetor të vitit 2010 në Seminarin e së Premtes janë prezantuar një sërë punimesh, si nga përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, ashtu edhe nga institucionet e tjera. Çështjet kryesore të trajtuara janë fokusuar në çështje të stabilitetit financiar dhe monetar, në ato të politikës fiskale si dhe në konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare në terma të produktivitetit të punës dhe kostos. Një përshkrim më i detajuar i materialeve të prezantuara është si më poshtë:

Tema e parë e prezantuar gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2010 është ajo me temë: “*Stress-Testing* mbi rrezikun indirekt të kreditit në Shqipëri, bazuar në karakteristikat e bankës” nga Kliti Ceca (Departamenti i Kërkimeve) dhe Hilda Shijaku (Departamenti i Stabilitetit Financiar). Ky material ka për qëllim analizimin e reagimit të raportit të kredive me probleme ndaj rreziqeve të mundshme makroekonomike si për shembull: kursi i këmbimit, normat e interesit dhe rritja ekonomike. Vlerësimi është bërë me anë të metodës *panel data*, ku janë përfshirë

të dhënat e 10 bankave që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri, gjatë periudhës 2005T01-2009T04.

“Qeverisja e bankave: Pse është e rëndësishme? Ku qëndron e veçanta e saj? Dhe çfarë kuptojmë me të” nga Sonila Bicaku, përfaqësuese e IFC (International Finance Cooperation-Europe & Central Asia). Disa nga çështjet që u trajtuan në këtë prezantim kishin të bënin me qeverisjen e korporatave në përgjithësi, arsytet pse duhet t’i kushtojmë vëmendje qeverisjes së bankave, të veçantat dhe problemet që shfaqen gjatë qeverisjes së tyre.

Tema “Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në. Integrimi tregtar dhe implikimet ekonomike” nga Alban Pllaha, Departamenti i Kërkimeve. Çështjet e trajtuara në këtë material kishin të bënin me procesin e stabilizim-asociimit dhe integrimin rajonal në përgjithësi. Ky material ofroi një këndvështrim mbi ekonominë shqiptare gjatë periudhës së tranzicionit, si dhe vlerësoi nivelin aktual dhe potencial të tregtisë të vendit tonë me partnerët tanë

tregtarë, bazuar në vlerësimet empirike të modelit të gravitetit për Shqipërinë. Disa nga konkluzionet e nxjerra janë që: integrimi evropian shkakton rritje të mëtejshme ekonomike, si dhe rezultatet empirike të modelit të gravitetit tregojnë se intensifikimi i tregtisë midis vendeve të rajonit dhe Shqipërisë do të bëhet me integrimin e mëtejshëm të vendit tonë drejt vendeve të BE-së dhe atyre të rajonit.

“Efektet makroekonomike të politikës fiskale: përjasja me SVAR” nga Armela Maçellari, Departamenti i Kërkimeve. Qëllimi kryesor i këtij materiali është vlerësimi i efekteve të politikës fiskale në Prodhimin e Brendshëm Bruto, çmimet dhe normën e interesit në Shqipëri me anë të modelit të Vektorëve Autoregresivë Strukturorë, për periudhën 1998T02-2009T04. Nga vlerësimet empirike rezultoi që politika fiskale në Shqipëri ka efekt të konsiderueshëm në ekonomi, ndërkohë që analiza e multiplikatorëve të politikës fiskale, konfirmoi se politika e uljes së taksave rezulton si politika më stimuluese në ekonomi.

“Faktorët kryesorë makroekonomikë në përcaktimin e rrezikut të kredisë: Rasti i

Shqipërisë”, nga Irini Kalluci dhe Oriela Kodra, Departamenti i Kërkimeve. Qëllimi kryesor i këtij materiali është identifikimi i faktorëve kryesorë që përcaktojnë raportin e kredisë totale me probleme, ashtu edhe kredinë për biznes dhe për individë. Metoda e vlerësimit është Metoda e Katrorëve më të Vegjël dhe përfshin periudhën 2002T02-2009T04. Disa nga rezultatet tregojnë që raporti i kredisë totale me probleme ndikohet nga norma e interesit të bonove të thesarit, REER, eksportet, agregati M3 dhe nga indeksi i çmimit të konsumit.

“Pozicioni konkurrues i ekonomisë shqiptare në terma të produktivitetit e të kostos së punës” nga Evelina Çeliku dhe Iris Metani, Departamenti i Politikës Monetare. Ky material ka për qëllim matjen, njohjen dhe analizimin e produktivitetit të punës dhe kostos për njësi të saj, duke marrë parasysh rëndësinë dhe implikimet që kanë këta tregues për politikën monetare. Bazuar në analizën krahasuese të treguesve relativë të produktivitetit dhe të kostos për njësi ka rezultuar se brishtësia dhe mungesa e avantazheve konkurruese të ekonomisë sonë vjen nga diferencat e larta të produktivitetit të punës.

## II. PUNËT KËRKIMORE TË SAPOPËRFUNDUARA

### “MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIIMIT BE-SHQIPËRI” – NGA ALBAN PLLAHA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE

Ky material analizon marrëdhëniet dypalëshe të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Në fokus të këtij materiali është Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, e veçanërisht,

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me vendet e rajonit, rezultatet e shkëmbimeve tregtare ndërmjet palëve, si dhe aplikimi i “Gravity Model”, i cili prodhon të dhëna parashikuese që mundësojnë krahasimin e volumeve tregtare aktuale me ato potenciale. Rezultatet e modelit sugjerojnë se volumet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të BE-së, si Greqia dhe Italia, janë pranë ekuilibrit potencial të

mundshëm, ndërsa ekziston hapësira për intensifikimin e shkëmbimeve tregtare me Gjermaninë. Rezultatet e modelit për shkëmbimet tregtare me vendet e rajonit sugjerojnë se volumet tregtare me këto vende janë shumë më poshtë ekuilibrit potencial. Studimi sugjeron mundësinë e intensifikimit të shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë me vendet e rajonit nëpërmjet përmirësimit të rrjetit infrastrukturor dhe integritit të mëtejshëm. Kështu, me anë të aplikimit të plotë të MSA-së, volumet tregtare do të intensifikohen ndjeshëm jo vetëm me partnerët tregtarë tradicionalë, por edhe me vendet e tjera të BE-së.

#### **“EFEKTET MAKROEKONOMIKE TË POLITIKËS FISKALE NË SHQIPËRI: PËRQASJE ME SVAR” - NGA ARMELA MANÇELLARI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Ky studim vlerëson efektin e politikës fiskale në Prodhimin e Brendshëm Bruto, çmimet dhe normën e interesit në Shqipëri. Politika fiskale e ushtron presionin e saj në dy forma: me anë të uljes së taksave si dhe me anë të rritjes së shpenzimeve qeveritare. Për vlerësimin e politikës monetare është përdorur modeli i Vektorëve Autoregresivë Strukturorë (SVAR) për periudhën 1998T02-2009T04. Identifikimi i goditjeve fiskale është bazuar në strukturën e kodit fiskal dhe strukturën e vendimmarrjes bazuar në metodologjinë e Blanchard dhe Perotti (2002). Rezultatet kryesore tregojnë se ulja e taksave ka multiplikatorin kumulativ më të lartë të PBB-së, çka sugjeron mungesën e ekuivalencës Rikardiane tek konsumatorët shqiptarë. Midis shpenzimeve kapitale dhe korente, multiplikatori i shpenzimeve kapitale rezulton më i lartë se ai i shpenzimeve korente. Ndikimi i shpenzimeve tek

normat e interesit rezulton statistikisht jo i rëndësishëm, ndërsa efekti i uljes së taksave rezulton me një ulje të lehtë të normave të interesit. Së fundmi, rritja e shpenzimeve korente rezulton në rritje të lehtë të normave të çmimeve; ndërsa ulja e taksave ul në mënyrë të menjëhershme nivelin e çmimeve me rreth 55 pikë bazë.

#### **“FAKTORËT KRYESORË MAKROEKONOMIKË NË PËRCAKTIMIN E RREZIKUT TË KREDISË: RASTI I SHQIPËRISË” – NGA IRINI KALLUCI DHE ORIELA KODRA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Ky studim analizon përcaktuesit kryesorë makroekonomikë të kredive me probleme në sistemin bankar shqiptar, jo vetëm për totalin e kredive, por edhe për secilin prej llojeve të kredisë (kredi për biznese apo për individë). Rezultatet empirike bazuar në Metodën e Katrorëve më të Vegjël tregojnë se kreditë me probleme të sektorit privat, ndikohen nga normat e bonove të thesarit 12-mujore, ndërsa cilësia e portofolit të kredive për bizneset ndikohet nga normat e bonove të thesarit 3-mujore, REER, agregati M3, eksportet, si dhe rritja ekonomike.

#### **“MADHËSIA DHE QËNDRUESHMËRIA E DEFICITIT KORENT NË SHQIPËRI” – NGA ILIR VIKA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Ky studim synon të masë madhësinë apo normën e bilancit korent duke u mbështetur në dy metoda: kuadri kontabël dhe teknikat ekonometrike, për të krijuar një panoramë sa më reale mbi qëndrueshmërinë e pozicionit të jashtëm. Struktura e thjeshtë e metodës së parë i bën implikimet e saj lehtësisht të

kuptueshme. Analiza e sensitivitetit sipas kësaj metode na jep vlerësime të shpejta rreth ndjeshmërisë së bilancit të jashtëm ndaj rritjes së PBB-së dhe reduktimit të diferencës së kthimit të borxhit të jashtëm. Kështu përlogaritjet që përftohen nga kuadri kontabël shërbejnë si pika të vlefshme referimi, ndërsa teknikat ekonometrike mbështeten në vlerësime empirike që testojnë përcaktues të ndryshëm të llogarisë korente, direkt ose indirekt, të cilët nuk janë të kufizuar nga kuadri teorik.

#### **“NJË VLERËSIM BAYESIAN I MODELIT STRUKTOROR PËR RASTIN E SHQIPËRISË” – NGA ELONA DUSHKU DHE VASILIKA KOTA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Ky material ka për qëllim prezantimin e një modeli të vogël strukturor për ekonominë shqiptare, duke përdorur teknikat Bayesiane të vlerësimit në Dynare dhe Matlab. Ky model është mjaft i përshtatshëm për ekonominë shqiptare, pasi merr në konsideratë të gjitha karakteristikat e saj, si dhe paraqet të gjitha lidhjet midis instrumentit të politikës monetare dhe ndryshoreve kryesore makroekonomike si: prodhimi, inflacioni, kursi i këmbimit dhe papunësia. Struktura e modelit është bazuar në studimin e Carabenciov et al. (2008), por është pasuruar me kanalin e kursit të këmbimit, si një kanal i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare. Në material janë prezantuar rezultatet e para të vlerësimit, performanca e modelit si dhe paraqitja e reagimi i ndryshoreve kryesore në model, si rezultat i goditjeve në hendekun e prodhimit, inflacionit dhe normës së interesit të politikës monetare.

#### **“STRESS-TESTING MBI RREZIKUN INDIREKT TË KREDITIT NË SHQIPËRI, BAZUAR NË KARAKTERISTIKAT E BANKËS” – NGA KLITI CECA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE DHE HILDA SHIJAKU, DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR**

Materiali studion reagimin e raportit të kredive me probleme ndaj kushteve makroekonomike, që përkeqësojnë aftësinë pagueuse të huamarrësve në sistemin bankar shqiptar. Ky ndikim vihet re nëpërmjet kanaleve të rrezikut të kredisë, bazuar në karakteristikat kryesore të bankave si: madhësia, pronësia, kapitalizimi dhe tipare të tjera të portofolit të kredisë. Empirikisht, modeli është vlerësuar me anë të metodës me *panel data*, për 10 banka që veprojnë në Shqipëri gjatë viteve 2005-2009. Disa nga rezultatet e marra tregojnë që: cilësia e portofolit të kredisë varet nga goditjet e PBB-së; nuk u gjetën evidenca për portofolin e kredisë në lekë, duke sugjeruar që kanali i kredisë mbetet akoma pak i ndikuar nga transmetimi i politikës monetare, si dhe kursi i këmbimit dhe normat e interesit në monedhë të huaj janë faktorët përcaktues në cilësinë e kredisë.

#### **“PËRCAKTUESIT E REMITANCAVE NË SHQIPËRI” – NGA ESIDA ABAZAJ, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Ky studim synon të masë empirikisht përcaktuesit makroekonomikë të dërgesave të emigrantëve në Shqipëri, gjatë periudhës 1996-2009. Metodot empirike të përdorura janë: Metoda e Katrorëve të Vegjël dhe Mekanizmi i Vektorit të Korrigjimit të Gabimit për të studiuar dinamikën afatshkurtër dhe afatgjatë të remitancave. Në përfaqjen

e parë, gjetjet mbështesin motivin altruist të emigrantëve shqiptarë. Në afatin e shkurtër, remitancat në Shqipëri rriten me mbiçmimin e Lekut dhe me rritjen e inflacionit, duke kompensuar kështu humbjen e fuqisë blerëse në vendin e origjinës. Ndërsa, në përqasjen e dytë, efekti altruist i kursit të këmbimit e humb rëndësinë e vet. Në të dyja përqasjet, remitancat rezultojnë të jenë shumë të ndjeshme ndaj aktivitetit ekonomik në Eurozonë, ku është lokalizuar pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë.

#### **“VLERËSIMI I EFEKTIT AFATGJATË TË TURIZMIT NË RITJEN EKONOMIKE TË SHQIPËRISË” – NGA JONEL KRISTO, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Ky studim synon të masë efektin e sektorit të turizmit në rritjen e përgjithshme ekonomike të vendit tonë, gjatë periudhës 1995-2008. Nëpërmjet analizës së fluksit të vizitorëve të huaj dhe të ardhurave totale reale në ekonomi, është studiuar lidhja afatgjatë e turizmit me rritjen ekonomike. Vlerësimi përfundimtar sugjeron se për çdo 5% rritje të qëndrueshme në të ardhurat nga turizmi, ekonomia rritet me

1%. Gjithashtu, çdo prishje e këtij ekuilibri kërkon 3.4 tremujorë që të korrigojëhet.

#### **“INTEGRIMI RAJONAL DHE EFEKTET NË RITJEN EKONOMIKE: IMPLIKIMET NË IHD DHE TREGTI” – NGA JONEL KRISTO, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Përqasja rajonale ndaj zhvillimit është ideja kryesore e studiuar në këtë punim. Efektet ekonomike në kontekstin e rajonalizimit si fazë paraprake e integritimit evropian janë marrë në konsideratë për Shqipërinë, duke i vënë theks të veçantë rolit të investimeve të huaja dhe tregtisë ndërkombëtare. Metoda panel me efekte fikse dhe rezultatet e analizës sugjerojnë që një rajon i integruar rritet më shumë në volum nëse stimulon integrimin tregtar dhe konvergjencën ndërindustriale në nivel ndërkombëtar, krahasuar me një rajon me mungesë të këtyre nismave. Një rajon i tillë tërheq gjithashtu më shumë investime të huaja, por analiza tregon se kushti paraprak për këtë është krahu i punës kompetent dhe i disponueshëm. Rezultatet janë të vlefshme në kontekstin e një rajoni ku mbizotëron industria e kostos, dhe jo industria e teknologjisë së lartë.

### **III. MATERIALE DISKUTIMI NË PROCES**

#### **“BORXHI PUBLIK, HIPOTEZAT E RRËNJËS NJËSI DHE THYERJET STRUKTURE: RASTI I SHQIPËRISË” – NGA GERTI SHIJAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Materiali ka për qëllim vlerësimin e qëndrueshmërisë së politikës fiskale në Shqipëri sipas përqasjes së zhvilluar nga

Trahan dhe Walsh (1991) dhe Taylor (2002). Fokusi kryesor do t'i kushtohet testeve diagnostike jolineare. Rezultatet e marra shërbejnë si material referues në fazën e vlerësimit dhe evidentimit të një forme të rregullit fiskal, por nuk mund të japin një vlerësim për sjelljen e politikës fiskale në të ardhmen.

**“STABILITETI FINANCIAR NË KUADRIN E NJË MODELI DSGE” – NGA ARDIAN FULLANI, GUVERNATOR I BANKËS SË SHQIPËRISË DHE ALTIN TANKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Ky material ka për qëllim aplikimin e një modeli teorik, si ai i DSGE-së, bazuar kryesisht në dy faktorë prodhimi, si dhe inkorporimin e stabilitetit financiar në të. Materiali paraqet edhe mënyrën se si ky model mund të zgjidhet drejt nivelit ekuilibër afatgjatë me kufizime afatgjata për stabilitetin financiar, bazuar në metodën e aplikuar nga Blanchard dhe Kahn (1980).

**“MONTE CARLO SIMULATION TEK MEAM” –KLITI CECA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Ky material ka për qëllim ndërtimin e intervaleve të besimit për projeksionet që rezultojnë nga përdorimi i modelit MEAM, si dhe vlerësime të gabimit statistikor. Metodatat e përdorura për ndërtimin e tyre

janë metodatat e Monte Carlos, të cilat janë teknika probabilitare, që kanë për qëllim gjetjen e metodave për gjenerimin e numrave të rastit.

**“AGREGIMI ALTERNATIV MONETAR NË SHQIPËRI NËPËRMJET PESHIMIT TË CILËSIVE LIKUIDE TË PËRBËRËSVE” – JONEL KRISTO, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Agregimi monetar aktualisht bëhet nëpërmjetshumëssëthjeshtëtëpërbërësve, duke supozuar se cilësitë likuide të tyre janë të njëjta. Kjo nënkupton që secili prej tyre mund të përdoret si zëvendësues i tjetrit për përmbushjen e funksioneve të parasë. Teorikisht një metodë e tillë është monetarisht e pasaktë, sepse agregatët monetarë ndryshojnë thelbësisht në cilësitë likuide që mbartin. Ky studim propozon agregimin monetar duke i dhënë pesha të caktuara çdo përbërësi, pesha të ndara sipas nivelit të likuiditetit dhe kostos oportune të përdorimit të parasë.

## IV. ARTIKUJ

Artikujt e përgatitur nga Departamenti i Kërkimeve gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2010 janë si më poshtë:

**“NJË ANALIZË E RREZIKUT DHE KTHIMIT PËR SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR” - NGA IRINI KALLUCI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE**

Ky artikull bazohet në analizën e rrezikut dhe performancës së sistemit bankar shqiptar bazuar në indeksin e rrezikut për sistemin bankar shqiptar. Llogaritja e këtij indeksi është bazuar në metodologjinë e

prezantuar nga Hannan dhe Hanweck në 1988. Bazuar në ecurinë e këtij indeksi, për sistemin bankar shqiptar vërejmë se ky indeks ka pësuar luhajtje në kohë, por niveli mesatar i tij gjatë periudhës dhjetor 2001- shtator 2010 shënon vlerën 7.2 njësi. Kështu ky indeks merr vlera poshtë nivelit mesatar, gjatë periudhës së krizës financiare globale, çka nënkupton një pritshmëri për një nivel më të lartë të rrezikut, ndërsa një përmirësim i vlerës së indeksit nënkupton një situatë më optimiste dhe një rigjallërim të aktivitetit bankar.

## V. TË NDRYSHME

### MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT ME UNIVERSITETIN E OKSFORDIT

Banka e Shqipërisë më 8 shtator 2010 nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit për tre vitet në vazhdim me Universitetin e Oksfordit me qëllim rritjen e kapacitetit kërkimor, thellimin e njohurive për zhvillimin e politikave ekonomike dhe përballjen me sfidat e vazhdueshme, që Shqipëria dhe vendet e rajonit duhet të ndër marrin në mënyrë që të nxisin rritjen ekonomike në kontekst të bashkëpunimit rajonal dhe të integritit drejt Bashkimit Evropian. Bashkëpunimi do të konsistojë në ndërmarrjen e një seri studimesh mbi politikën ekonomike të vendit dhe të rajonit, të cilat do të ndihmojnë debatin shkencor rreth modelit të rritjes ekonomike, mbështetur edhe nga një këndvështrim rajonal në nivelin social, ekonomik dhe në atë politik. Gjithashtu, bashkëpunimi do të konsistojë në çështje që lidhen me efektivitetin e politikës monetare, rëndësinë e ankorave ekonomike të brendshme dhe të jashtme, ngritjen e kapaciteteve kërkimore në funksion të zbatimit të politikave tona, si dhe në komunikimin dhe edukimin e publikut. Qasja e duhur ndaj këtyre çështjeve është një domosdoshmëri për politikën monetare dhe për rolin e saj themelor në arritjen e mirëqenies ekonomike.

### TAKIMI I KATËRT RAJONAL: "KËRKIMET EKONOMIKE NË EVROPËN JUGLINDORE"

Në datat 18-19 nëntor në Tiranë, Banka e Shqipërisë organizoi takimin e katërt rajonal, me temë "Kërkimet

Ekonomike në Evropën Juglindore". Në të morën pjesë 25 përfaqësues (prezantues dhe diskutantë) nga Banka e Shqipërisë dhe nga bankat qendrore të rajonit, ku përmendim Bankën e Italisë, Bankën e Austrisë, Bankën e Polonisë, Bankën e Greqisë etj. Duke ndjekur suksesin e tre takimeve të mëparshme, qëllimi i këtij takimi ishte të përmirësonte më tej bashkëpunimin dhe dialogun e hapur midis kërkuesve ekonomikë, si dhe të zgjeronte më tej njohuritë e bankave qendrore të rajonit mbi karakteristikat dhe zhvillimet specifike të vendeve pjesëmarrëse.

Takimi i katërt rajonal zgjati 2 ditë dhe ishte i organizuar në tre seksione kryesore, të ndara si më poshtë:

1. Krizat globale dhe sektorët financiarë e makroekonomikë të ekonomive të Evropës Juglindore, duke u fokusuar në:
  - mësimet e nxjerra gjatë krizës,
  - rreziqet potenciale dhe analiza e *stress-test-eve*, që duhet të zhvillohen dhe implementohen nga bankat qendrore.
2. Ankorat e reja për politikën ekonomike.
3. Rregullimet e zbalancimeve të brendshme e të jashtme: nevoja për përpjekje të vazhdueshme nëpërmjet reformave strukturore, me qëllim nxitjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme.

Më poshtë mund të gjeni një renditje të temave të prezantuara në këtë takim:

1. "Testimi i përhapjes epidemike së krizës financiare në sistemin bankar evropian", nga Emidio Coccozza,

- Banka e Italisë.
2. "Vlerësimi i lidhjes kapital-rrezik për bankat e nivelit të dytë në rajonin e Evropës Juglindore", nga Panayiotis Athanasoglou, Banka e Greqisë.
  3. "Një model për rrezikun e kredisë në Shqipëri duke përdorur të dhënat panel të bankave", nga Kliti Ceca dhe Hilda Shijaku, Banka e Shqipërisë.
  4. "Përcaktuesit makroekonomikë të rrezikut të kredisë", nga Oriela Kodra dhe Irini Kalluci, Banka e Shqipërisë.
  5. "Ekspozimi i huave në valutë të individëve në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore anëtare të BE-së, dhe në Kroaci", prezantuar nga Katharina Steiner, Banka e Austrisë.
  6. "Niveli i rezervës optimale: Rasti i Shqipërisë", nga Gerti Shijaku, Banka e Shqipërisë.
  7. "Një vlerësim Bayesian i modelit strukturor për rastin e Shqipërisë", nga Elona Dushku dhe Vasilika Kota, Banka e Shqipërisë.
  8. "Efektet makroekonomike të politikës fiskale në Shqipëri: Përfaqja me SVAR", nga Armela Mançellari, Banka e Shqipërisë.
  9. "A ndryshoi gjithçka kriza financiare? Evidenca nga politika fiskale dhe monetare", nga Ljupka Georgievska, Banka e Maqedonisë.
  10. "Stabiliteti financiar në kuadrin e një modeli DSGE", nga Altin Tanku, Banka e Shqipërisë.
  11. "Inflacioni dhe zhvillimi financiar", nga Vasilika Kota, Banka e Shqipërisë.
  12. "Çmimet e Eksporteve në Bullgari dhe sjellja e ngurtësisë së tyre", Emilia Penkova dhe Peter Sinclair, Banka e Bullgarisë.
  13. "Madhësia dhe qëndrueshmëria e deficitit korrent në Shqipëri", nga Ilir Vika, Banka e Shqipërisë.
  14. "Zhurmat e transmissioinit të politikës monetare gjatë krizës financiare: Rasti i një ekonomie në zhvillim", nga Eva Wrobel, Banka e Polonisë.
  15. "Përcaktuesit e remitancave në shqipëri", nga Esida Abazaj, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.
  16. "Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri: Modeli i Gravitetit për tregtinë", nga Alban Pllaha, Banka e Shqipërisë.
  17. "Integrimi rajonal dhe efektet në rritjen ekonomike: Implikimet në IHD dhe tregti", nga Jonel Kristo, Banka e Shqipërisë.
- Secili nga materialet e prezantuara u shoqërua nga një diskutim i të ftuarve, që paraqiste gjetjet kryesore të materialit, kontributin si dhe duke dhënë komentet dhe sugjerimet përkatëse.
- Ky takim rajonal rezultoi mjaft i frytshëm dhe i suksesshëm, duke treguar haptazi për herë të katërt, interesin në rritje për kërkimin dhe diskutimin ekonomik në rajon dhe për rajonin. Për këtë arsye ne kemi bindjen që në të ardhmen do të intensifikohen bashkëpunime të tilla me banka të tjera qendrore të rajonit.

### **ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2010**

Për të katërtin vit radhazi Banka e Shqipërisë ofron Çmimin e Guvernatorit për Diplomën më të Mirë për Vitin 2010. Ky çmim inkurajon studentët shqiptarë të diplomuar gjatë këtij viti, brenda dhe jashtë vendit, për punë shkencore në çështje të lidhura me ekonomiksion monetar, stabilitetin financiar, integrimin



ekonomik të Ballkanit në Evropë, veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, sistemin bankar shqiptar dhe ekonominë në përgjithësi. Është një traditë e mirë që shërben për krijimin e një kulture kërkimesh dhe krijimin e një strukture mbështetëse me elementë të rinj që nuk kanë vetëm dëshirën, por edhe njohuritë e nevojshme për të studiuar fenomenet ekonomike në vend dhe rajon.

Kështu për vitin 2010, vendin e parë e fitoi znj. Lorena Skufi, e cila ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, me temën: "Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri. Një përjasje empirike për Shqipërinë".

Vendin e dytë e fitoi znj. Fabiola Hysenbelliu, e cila ka përfunduar studimet në Shkollën e Ekonomiksit dhe Shkencave Politike të Londrës, me temën: "Deri në ç'pikë axhenda e integritit të Shqipërisë është duke ecur drejt kërkesave standarde të Bashkimit Evropian në fushën e politikës dhe qeverisjes?".

Dhe vendin e tretë e fitoi znj. Evisi Kopluku, e cila ka përfunduar studimet pasuniversitare në Universitetin Mesdhetar Lindor të Qipros Veriore, me temë: "Ndikimi i krizës botërore financiare në ekonominë e Evropës Juglindore".

### SEMINARI TEKNIK

Një tjetër aktivitet që zhvillohet nga Departamenti i Kërkimeve, në kuadër të Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, është ai i Seminarit Teknik që organizohet një herë në dy muaj. Ky seminar ka si objekt prezantimin e të rejave më të fundit shkencore në fushën e ekonomisë,

metoda të reja të zgjidhjes së problemeve të ndryshme, zhvillimin e modeleve origjinale matematikore të proceseve dhe fenomeneve, si dhe rezultatet e marra nga përdorimi i tyre etj. Gjatë periudhës korrik-dhjetor të vitit 2010 janë organizuar dy prezantime që kanë trajtuar këto tema:

- i) Përjasje praktike e simulimit Monte Carlo
- ii) Metodatat e GMM dhe TSLS

Materiali me temë: "Përjasja praktike e simulimit Monte Carlo" u prezantua nga Kliti Ceca, Departamenti i Kërkimeve. Ky material është vazhdim i materialit me temë: "Simulimi i ndryshoreve të rastit, metoda dhe zbatime", i prezantuar në gjashtëmuorin e parë të vitit 2010. Qëllimi i këtij seminari ishte prezantimi i shembujve të ndryshëm të gjenerimit të disa lloje ndryshoresh, si dhe u paraqitën ato procese që kanë një përdorim më të shpeshtë në praktikë.

Një tjetër material i prezantuar është ai me temë: "Metodat e GMM dhe TSLS", nga Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve. Qëllimi i këtij materiali ishte njohja me dy metoda të tjera për vlerësimet empirike që janë: Metoda e Përgjithësuar e Momenteve (GMM) dhe Metoda e dy Fazave të Katrorit (TSLS). GMM-ja rrjedh nga të ashtuquajturat kushte të momentit ose nga supozimet e modelit empirik dhe konsiderohet si një përjasje vlerësuese e përshtatshme për analizimin e modeleve dinamike jolineare në mungesë të informacionit të plotë mbi shpërndarjen probabilitare të të dhënave. Ndërsa, metoda e TSLS është një mënyrë tjetër për vlerësimin e modeleve empirike, të cilat nuk plotësojnë supozimet bazë të përjasjes së MZKV-së, sidomos supozimin

e ekzogjenitetit dhe përbëhet nga dy faza ose etapa:

1. Gjatë fazës së parë, TSLS gjen pjesë të variablave endogjenë dhe ekzogjenë që mund t'i atribuohen instrumenteve. Kjo fazë përfshin vlerësimin e një regresioni MZKV
2. Ndërsa, në fazën e dytë bëhet vlerësimi i ekuacionit origjinal me të gjithë variablat e zëvendësuar nga regresioni në fazën e parë. Koeficientët e këtij regresioni janë vlerësime të TSLS.

të çdo ndryshori në modelin mbi grupazhin e instrumenteve.

**LINQE:****PUNË KËRKIMORE TË BANKAVE TË TJERA QENDRORE**

European Central Bank (<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>)

Bank of Greece (<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>)

Deutsche Bundesbank ([http://www.bundesbank.de/vfz/vfz\\_diskussionspapiere\\_2009.en.php](http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php))

Oesterreichische Nationalbank ([http://www.oenb.at/en/presse\\_pub/research/research.jsp](http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp))  
Banca d'Italia (<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>)

Czech National Bank (<http://www.cnb.cz/en/research/>)

Banco de Espana (<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>)

Bank of Finland ([http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit\\_julkaisut/index.htm](http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm))

Bank of England (<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>)

Federal Reserve (<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>)

**TË TJERA**

BIS Central Bank Research Hub (<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>)

International Journal of Central Banking (<http://www.ijcb.org/>)

National Bureau of Economic Research (<http://www.nber.org/>)

International Monetary Fund (<http://www.imf.org/external/pubind.htm>)

ECB Research Bulletin (<http://www.ecb.int/pub/pdf/other>)

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Avni Rustemi", Nr.24, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3

Faks: + 355 4 2419408

E-mail: [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Tirazhi: 600 kopje

Shtypur në shtypshkronjën *AdelPrint*